



UNMIK/REG/2001/2
12 janar 2001

RREGULLORE NR. 2001/2

**MBI NDRYSHIMET E RREGULLORES SË NDRYSHUAR TË
UNMIK-ut, PËR EMËRIMIN DHE SHKARKIMIN E
GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTARË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/6 të datës 15 shkurt 2000 mbi Emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë dhe Rregullores nr. 2000/34 të datës 27 maj 2000 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/6,

Me qëllim të përmirësimit të procesit gjyqësor dhe administrimit korrekt të drejtësisë,

Ndryshon Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/6 me ndryshimin e nenit 5 dhe me shtimin e paragrafeve të reja 1.4, 1.5, 1.6, dhe 7 dhe rinumëron nenin e mëparshëm 6 në nenin 8.

Rrjedhimisht, nga data e hyrjes në fuqi rregullorja do të ketë formulimin e mëposhtëm:

RREGULLORE NR. 2000/6

MBI EMËRIMIN DHE SHKARKIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTARË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të dates 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim që të ndihmohet procesi gjyqësor në Kosovë,

Shpall sa vijon:

Neni 1

Emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë

- 1.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të emërojë dhe shkarkojë gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë, duke marrë parasysh kriteret e parapara në nenin 2 dhe 4 të kësaj rregulloreje. Emërimet e tilla mund të bëhen në cilëndo gjykatë apo prokurori publike në territorin e Kosovës.
- 1.2 Gjyqtarët ndërkombëtarë gëzojnë autoritetin dhe përgjegjësinë për t'i përmbushur obligimet e pozitës së tyre, duke përfshirë edhe autorizimin për të marrë përgjegjësinë për lëndët e reja penale, të cilat presin të shqyrtohen brendapërbrenda juridiksionit të gjykatës ku ai/ajo është emëruar.
- 1.3 Prokurorët ndërkombëtarë gëzojnë autoritetin dhe kanë përgjegjësi t'i kryejnë funksionet e tyre, duke përfshirë edhe autorizimin dhe përgjegjësinë për administrimin e hetimeve penale dhe ndërmarrjen e përgjegjësisë për procedura të reja hetimore ndaj atyre që presin të hetohen brendapërbrenda juridiksionit të prokurorisë ku ai/ajo është emëruar.

1.4 Prokurori ndërkombëtar mund të ndërmarrë, rifillojë ose vazhdojë ndjekjen penale të një rasti, duke përdorur procedurat e zbatueshme për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ashtu siç parashihet në nenet 60 dhe 61 dhe nenet e përafërta të zbatueshme të Kodit të Procedurës Penale të Jugosllavisë. Gjatë ushtrimit të pushtetit, prokurori ndërkombëtar:

- (a) do të ketë të gjitha të drejtat si prokuror publik dhe funksionin e tij do ta ushtrojë si zyrtar i qeverisë;
- (b) do të ndërmarrë, rifillojë ose vazhdojë ndjekjen penale brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të shënuar në paragrafin 1.6 dhe
- (c) nuk do të detyrohet t'u përmbahet kërkesave dhe procedurave të neneve 403-407 të përfshira në Kodin e aplikueshëm të procedurës penale të Jugosllavisë.

1.5 Prokurori ndërkombëtar, në pajtim me nenin 171 të Kodit të procedurës penale të Jugosllavisë, mund të ankohet në vendimin e trupit gjykues për mosshqyrtimin e ndonjë çështjeje.

1.6 Autoritetet përgjegjëse për njoftimin e palës së dëmtuar, sipas neneve 60 dhe 61 të Kodit të aplikueshëm të procedurës penale të Jugosllavisë, do ta informojnë edhe prokurorin kompetent ndërkombëtar të caktuar në gjykatën relevante të qarkut ose në prokurori brenda afatit prej katërmëdhjetë (14) ditëve. Nëse nuk është caktuar asnjë prokuror ndërkombëtar në gjykatë të qarkut ose në prokurori, autoritetet përgjegjëse do ta informojnë Departamentin e Drejtësisë dhe ai menjëherë do ta informojë prokurorin ndërkombëtar.

Neni 2

Kriteret për gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë

Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë duhet:

- (a) të kenë diplomë të fakultetit juridik;
- (b) të kenë qenë të emëruar dhe të kenë shërbyer si gjyqtarë dhe prokurorë më së paku pesë vjet në shtetin e tyre përkatës;

(c) të kenë integritet të lartë moral dhe

(ç) të mos kenë dosje penale.

Neni 3

Betimi ose deklarata solemne

Çdo gjyqtar dhe prokuror ndërkombëtar me rastin e emërimit do ta jep betimin ose deklaratën solemne para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm si vijon:

“Unë, _____, betohem (ose deklarohe) solemnisht se:

Gjatë kryerjes së detyrës sime do të veproj në pajtim me standardet më të larta profesionale dhe me respektin më të madh për dinjitetin e pozitës dhe detyrave të cilat më janë besuar. Do t'i përmbush detyrat e mia dhe do ta ushtroj autoritetin në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Gjatë përmbushjes së funksioneve të mia çdo herë do t'u përmbahem standardeve më të larta të të drejtave të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe parimet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Shoqërore, Kulturore dhe Ekonomike dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Lirive Fundamentale dhe Protokollet e saj.

Gjatë përmbushjes së detyrave dhe obligimeve të mia çdo herë do të përpiqem t'u sigurojë gjithë qytetarëve të Kosovës respektimin dhe gëzimin e drejtave të njeriut pa dallim prejardhje, gjinie, rase, ngjyre, religjioni, mendimi politik apo diç tjetër, prejardhje kombëtare apo shoqërore, bashkim me një grup minoritar, pasuri, status të lindjes ose diç tjetër.

Neni 4

Shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë

4.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shkarkojë gjyqtarin ose prokurorin ndërkombëtar për arsyt e mëposhtme:

(a) paaftësisë fizike dhe mentale, që ka gjasa të zgjasë apo të jetë e përhershme;

(b) keqadministrimit;

(c) dështimit në ekzekutimin e detyrave në mënyrë adekuate dhe

(d) pozitës jokompatibile në përmbushjen e detyrave adekuate të shkaktuar nga sjelljet personale apo diç tjetër.

4.2 Gjyqtari ose prokurori ndërkombëtar nuk mund të mbajë post tjetër publik apo administrativ i cili nuk pajtohet me funksionin e tij/saj dhe të angazhohet në ndonjë detyrë tjetër të natyrës profesionale qoftë me pagesë qoftë pa pagesë, apo të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër jokompatibil me funksionin e tij/saj.

Neni 5 Ligji i zbatueshëm

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë në ligjin e zbatueshëm që nuk është në pajtim me të.

Neni 6 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresë administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 7 Dispozitat kalimtare

Pavarësisht nga paragrafi 1.4 (b), prokurori ndërkombëtar mund të ushtrojë autoritetin që i është dhënë atij në paragrafin 1.4 në këtë rregullore, në rastet kur prokurori publik ka hequr dorë nga ndjekja penale para datës së kësaj rregulloreje, me kusht që prokurori ndërkombëtar të ushtrojë autoritetin e tillë jo më vonë se 30 ditë nga data e nxjerrjes së kësaj rregulloreje.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore¹ hyn në fuqi më 12 janar 2001.

¹ Rregullorja origjinale hyri në fuqi më 15 shkurt 2000

Bernard Kouchner
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm